



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/90
Datë: 29.10.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 tetor 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet ekstrakti i procesverbalit dhe transkripti nga mbledhja e 89 e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/90
Datë: 29.10.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 tetor 2009, mori

V E N D I M

Për përdorimin e llambave fluoreshente kompakte të ndriçimit

1. Në të gjitha institucionet publike, shtetërore dhe ndërmarrjet me kapital shtetëror, ato buxhetore dhe jo-buxhetore, duke filluar nga data 01.02.2010, për ndriçimin e mjediseve të brendshme dhe të mjediseve ndihmëse të tyre të përdoren llamba fluoreshente kompakte, klasi A i energjisë.
2. Titullarët e të gjitha institucioneve publike, shtetërore dhe të ndërmarrjeve me kapital shtetëror, atyre buxhetore dhe jo-buxhetore të marrin masat e nevojshme për zbatimin e pikës 1. të këtij vendimi.
3. Nëse konstatohet se titullari ose personi përgjegjës për çështjet administrative të institucionit nuk ka përmbushur kërkesën sipas pikës 1. të vendimit, ndaj tij merren masa administrative.
4. Ngarkohen institucionet publike, shtetërore dhe ndërmarrjet me kapital shtetëror, ato buxhetore dhe jo-buxhetore për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/90
Datë: 03.10.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, me propozimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 tetor 2009, mori

V E N D I M

1. Në Strategjinë Legjislative për vitin 2009 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të përfshihet edhe:
 - a) Projektligji për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës.
2. Ngarkohet Zyra për Shërbimet e Ndhmës Juridike në Zyrën e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAJI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/90
Datë: 29.10.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 30.3 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 tetor 2009, mori

V E N D I M

1. Lejohet transferi i mjeteve financiare, kategoria ekonomike - Shpenzime Kapitale, nga programi me kod 327 - Departamenti për Menaxhimin e Emergjencave, projekti me kod 11066 - "Rregullimi i depos për vendosjen e mjeteve piroteknike dhe eksplozive", në programin me kod 148 - Shërbimet e Regjistrimit, për projektin me kod 11062, "Ndërtimi i Qendrave Komunale të Regjistrimit Civil dhe Qendra e Regjistrimit të Automjeteve në Prishtinë" në shumën prej 281.000 (dyqindetëdhjetë e njëmijë) euro.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Ministria e Punëve të Brendshme.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë